



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0514-A0001**

***Në ankesën e***

***Paditësi/ankuesi***

**H O**, fshati Sh, Komuna Prishtinë- i përfaqësuar nga avokati, **H G**, Prishtinë.

***kundër***

***E paditura***

**NSH, K.B "Bujqësia"**, Prishtinë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1747 të datës 16 qershor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-1747 të datës 16 qershor 2022, dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN009-0081 i datës 23 gusht 2013.**

- 3. Obligohet AKP-ja-Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën 01.03.2007 deri 31.01.2008, shumen prej 1,782.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 178.20 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në Procedurën e Likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 21 shtator 2013, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN009-0081 të datës 23 gusht 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 deri 31.01.2008, në shumën prej 1,782.00 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë këtë vendim e konsideron si të kundërligjshëm, pasi që ai pohon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Tutje në ankesë ai pohon se kishte pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, nga ana e AKM-së, andaj duke u bazuar në këtë njoftim ai është paraqitë në procedurë të likuidimit me datë 15.10.2010, do të thotë në afatin ligjor, dhe nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0081 të datës 23 gusht 2013, autorizimin për përfaqësim, njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007.

Me 28 prill 2014, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për këto tri paga është parashkruar në bazë të nenit

608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me 06 qershor 2014, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë ai i përsërit pretendimet e veta të cekur në ankesë. Paditësi pohon se ka dëshmuar me prova që ka punuar në NSH deri me datë 31.01.2008 në pozitën e rojtarit e po ashtu ka dëshmuar edhe pagën të cilën ai e kishte në muajin shkurt 2007 duke ofruar regjistrin e pagave.

Me 25 korrik 2014, AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe kundërpërgjigjet në pretendimet e paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e i referohet përkufizimeve që janë paraqitur në mbrojtje. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për këto tri paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar dhe se pretendimi i paditësit se kërkesa e tij nuk është parashkruar është i pa bazuar.

Me 16 qershor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1747, ankesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, PRN009-0081, i datës 23.08.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se duke u bazuar në nenin 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, i cili parasheh: që kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disurbimet nga likuidimi. Në bazë të nenit 374 të Ligjit të Marrëdhënieve mbi detyrimet, ( botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr.29/1978, ligj i zbatueshëm në kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi), parashihet se "Kërkesat e ndërsjellat të personave juridik nga kontrata për tregtinë e mallrave dhe pretendimet për kompensimin e shpenzimeve të bëra në lidhje më

këto kontrata vjetërsohen për tre vjet”, që i bie nga marsi 2007 deri në mars 2010.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar pagat e pa paguara ka skaduar pas vitit 2010: Sipas nenit 608 të Ligjit mbi Punën e bashkuar, një kërkesë e tillë arrin afatin e parashkrimit të saj brenda 3 viteve. Neni 87 i Ligjit të punës nr.03/L212 e cila parasheh afatin e njëjtë kohor për përshkrimin e të gjitha kërkesave më para si rezultati i marrëdhënies së punës.

Shkallës e I-rë ka konstatuar se padia në fjalë në tersi refuzohet si e pa bazuar pasi që nuk ka asnjë provë përpara që paditësi e ka dorëzuar kërkesën para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent para se të përfundonte periodha e parashkrimit nga marsi 2007 deri në mars 2010. Afati i parashkrimit nuk ishte ndërprerë dhe për këtë paditësi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi.

Me 12 shtator 2022, paditësi/ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit ka parashtruar një ankesë në kolegjin e apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-1747, të datës 16 qershor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, që prishet Aktgjykimi i ankimuar, dhe lënda të kthehet në rigjykim ose në rivendosje në shkallën e I-rë. Paditësi në ankesën e parashtruar e kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak se ai pretendon që gëzon të drejtën për dëmshpërblim ngase si dëshmi e ka Kontratën mbi punën që i është ndërprere para afatit të përfundimit të saj, dhe se pushimi nga puna kishte ardhur si pasojë e vendimit të AL-së.

Paditësi në ankesë thekson se ka pranuar Njoftimin nga AKP-ja për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, dhe sipas këtij njoftimi, i është komentuar se shumat-pagat e papaguara që u janë borxh do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit. Andaj sipas ankuesit ky njoftim e ndërprente afatin e parashkrimit dhe konstatimi i shkallës së I-rë është i pa pranueshëm. Paditësi në ankesën e parashtruar thekson se duke u nisur nga parimet e përgjithshme mbi përshkrimin e aplikuar dhe referuar sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare e RSFJ nr.29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85,45/89,32/93) dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në bazë të nenit 366 paragrafi 1 thuhet, citat:” Njohja me shkrim e detyrimit të parashkuar

konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi". Paditësi ka theksuar neni 370, i po të njëjtit ligj thuhet : "Rregullat për parashkrim nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim nën kërcenim të humbjes së të drejtave". Në rastin konkret afati i parashkrimit rrjedh nga data 31 janar 2008 ngase me këtë datë parashtruesi i ankesës është njoftuar me shkrim se marrëdhënia e punës i ka prishur si pasojë-rezultat i shitjes së aseteve të NSH-së. Paditësi konsideron Shkalla e I-rë pranë DHPGJS-së, ka marrë këtë Aktgjykim si vendim të parë ngase më herët është zbatuar praktike ndryshe kur njoftimi e kishte ndërprerë afatin e parashkrimit.

Me 19 dhjetor 2023, AKP-ja e ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS, dhe përgjigjet në ankesën e paditësit. Në këtë parashtresë, AKP-ja i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditësit, dhe e mbështet në tërësi aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj, andaj i propozon kolegjit të apelit që ta refuzojë ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe ta vërtetojë Aktgjykimi e Shkallës së I-rë. Tutje AKP-ja pohon se paditësi vetëm i ka përsëritur argumentet e dhëna më herët, dhe konsideron se përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, dhe për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të Ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjykimit përkatës. Në këtë parashtresë, AKP-ja ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet, dhe të aprovohet padia si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 15 tetor 2010, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, për kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH "KB Bujqësia" ( në likuidim), për periudhën nga data 01.03.2007 e deri 31.01.2008, në shumë prej 1,782.00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të sakta konstatimin e Autoritetit të Likuidimit, se kërkesa është parashkruar. Kjo për faktin se kërkesa për paga është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 15 tetor 2010, dhe ajo kërkesë i përket periudhës nga data 01.03.2007 e deri në 31.01.2008, që do të thotë nuk ka kaluar afati ligjor prej 3 viteve, për të ardhur në konstatimin se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi bashkë me ankesën në Shkallën e I-rë, ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0081 të datës 23 gusht 2013, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007, në të cilën listë është edhe paditësi.

Paditësi e kishte pranuar Njoftimin nga AKM-ja për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, në kohën kur ende nuk kishte ndodhë parashkrimi, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pas fillimit të procedurës së likuidimit, ai me datë 15 tetor 2010 e paraqet kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, në afat ligjor.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me listën e pagave të punëtorëve për muajin shkurt të vitit 2007, ai ka vërtetuar edhe lartësinë e tij të pagës mujore.

Duke marrë për bazë këtë provë, paditësit i njihet e drejta në kompensimin e pagave për periudhën 01.03.2007 deri me 31.01.2008, për 11 paga në shumë prej 1,782.00 euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Shkalla e I-rë e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se në bazë të nenit 374 të Ligjit të Marrëdhënieve mbi detyrimet, ligj i zbatueshëm në kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, parashihet se "Kërkesat e ndërsjellat të personave juridik nga kontrata për tregtinë e mallrave dhe pretendimet për kompensimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me këto kontrata vjetërsohen për tre vjet", që i bie nga marsi 2007 deri në mars 2010. Gjithashtu Shkalla e I-rë ka konstatuar se afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar pagat e pa paguara ka skaduar pas vitit 2010. Sipas nenit 608 të Ligjit mbi Punën e bashkuar, një kërkesë e tillë arrin afatin e parashkrimit të saj brenda 3 viteve. Sipas konstatimit të Shkallës së I-rë, afati i parashkrimit nuk ishte ndërprerë dhe për këtë paditësi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi. Këtë konstatim të gabuar të Shkallës së I-rë, nuk e ka pranuar Kolegji i Apelit. Siç u tha me sipër paditësi ka sjell përveç Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës që dëshmon se ai ishte në punë në NSH "Bujqësia" në Fushë Kosovë deri me 31.01.2008, ai ka sjell edhe Listën e pagave për muajin shkurt 2007, në bazë të cilës vërtetohet edhe lartësia e pagës mujore të tij. Kjo Listë është nënshkruar nga Drejtori i NSH-së, dhe nuk ka arsye që kjo dëshmi të mos merret si dëshmi e besueshme. Këtë provë nuk e ka kontestuar shprehimisht AKP-ja në parashtresat e saja të dorëzuara në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë, përveç borxhit kryesor, ai ka kërkuar edhe kamatën ligjore, andaj pasi që paditësi është i suksesshëm në kërkesëpadinë e tij, në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit po ashtu i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 178.20 euro, të cilat do të paguhet nga e paditura, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovoi ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshoi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit, si dhe e aprovoi padinë si të bazuar.

Nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Paditësi konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 13 tetor 2022, në shumë prej 20 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_